

<p style="text-align: center;"><b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b></p>
--	---	--

Në padinë e

**ASC – 09 – 0053**

**Ndërmarrja Shoqërore** [REDACTED]

*Paditësi*

e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Ilir Konushevci 8, Prishtinë

kundër

[REDACTED]

*I padituri/Ankuesi*

E përfaqësuar nga [REDACTED] avokat në Prishtinë

[REDACTED]

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eja-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e të Paditurit/Ankuesit kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 14 gusht 2009, SCC-09-0154, pas seancës vendim marrëse të mbajtur më 4 shkurt 2010 lëshon këtë:

### **AKTVENDIM**

**Ankesa refuzohet si e pabazuar. Vërtetohet Aktvendimi i DHPGJS-së i datës 14 gusht 2009, SCC-09-0154.**

**Trupi Gjykses do të vendos për kërkesën e të Paditurit/Ankuesit për shpenzime gjyqësore në procedurën e ankimit.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale:**

Më 7 gusht 2009, Paditësi parashtrroi padi në DHPGJS në mënyrë që të urdhërojë të Paditurin të ndalojë çfarëdo veprimi për të ndryshuar statusin e fundit të posedimit faktik në lidhje me pasurinë e paluajtshme të regjistruar si ngastra kadastrave nr. 7155/1 dhe 7154/1 të cilat gjenden në 'Rruga Hekurudha' nr. 24-26 në Prishtinë (numri i lëndës SCC-09-0154).

Në bazë të kërkesës së Paditësit për masa të përkohshme të sigurisë dhe kërkesës për ndalim të përkohshëm, më 14 gusht 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së e lëshoi një ndalim të përkohshëm duke e urdhëruar të Paditurin/Ankuesin të ndalojë çfarëdo veprimi në lidhje me këto ngastra nr. 7155/1 dhe 7154/1 në Prishtinë, i cili do të mund të shpie në ndryshimin e statusit faktik të këtyre ngastrave, dhe të përmbahet nga çfarëdo veprimi mbi ngastrat e përmendura, veçanërisht por jo në mënyrë ekskluzive të përmbahet në dëmtimin dhe shkatërrimin e ndërtimeve. Në bazë të aktvendimit, ndalimi i përkohshëm do të mbetet në fuqi derisa të merret vendimi i prerë mbi meritat nga DHPGJS-ja. Së fundi, Paditësi është urdhëruar të depozitojë shumën prej 3.000 eurosh brenda 3 ditëve për të siguruar të Paditurin për ndonjë dëm nëse padia e Paditësit nuk do të vërtetohet.

Pas dërgimit të aktvendimit të përmendur më lartë, Paditësi, brenda tri ditëve, e paraqiti në DHPGJS garancinë bankare në shumë prej 3.000 euro.

Më 27 gusht 2009, i Padituri parashtrroi ankesë në të cilën kërkoi nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së që të anulohet ndalimin e përkohshëm dhe të kompensojë atë për shpenzimet dhe për pagesën e avokatit në shumën prej 2.000 euro. I Padituri pohon se Paditësi nuk është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), por është kompani private. AKP-ja nuk ka autoritet as të administrojë pronën e kompanisë private të "Izolimit", e as ta përfaqësojë atë në gjykatë. Në bazë të ankesës, parcelat tjera, numri i ngastrës 7154/1, afër hotelit dhe aty ku ka ndodhur rrënimin nuk ka qenë asnjëherë në pronësi shoqërore. I padituri nuk e posedon, dhe as nuk ka ndonjë interes tjetër në asnjërën nga ngastrat dhe nuk është përfshirë në asnjë aktivitet në pronën në fjalë. Edhe sikurse të kishte bazë ligjore për padinë, asnjë padi nuk është ushtruar më herët, apo me aplikim të Paditësit për ndalim të përkohshëm. Aplikimi është bërë pas përfundimit të rrënimin, dhe asnjë aktivitet nuk duket të jetë në periudhë të afërt. Për më tepër, nuk ka pasur rrethana të jashtëzakonshme që DHPGJS-ja të

mund të kishte vendosur mbi aplikimin e ndalimit të përkohshëm pa e bërë dërgimin e tij tek palët tjera.

Më 13 tetor 2009, Paditësi e parashtroi përgjigjen ndaj ankesës, duke i kërkuar Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së të refuzojë ankesën si të pabazë dhe që ndalimi i përkohshëm të mbetet në fuqi derisa të merrej vendimi i plotfuqishëm mbi meritat nga Trupi Gjykses. Paditësi pohon se më 21 maj 1997 është regjistruar si ndërmarrje shoqërore dhe zyrat e saj u themeluan në pronën e kontestuar. Prona e Paditësit më vonë u uzurpuan dhe zyrat e Paditësit ishin rrënuar. Ngastrat numër 7155/1 dhe 7154/1 janë regjistruar në Regjistrin Kadastral në Prishtinë në emër të Paditësit derisa në mënyrë joligjore u këmbyen nga Z. [REDAKTUAR], pronar i [REDAKTUAR]

Përgjigja e Paditësit i është dërguar të Paditurit/Ankuesit më 9 dhjetor 2009.

### **Arsyetimi ligjor**

Kolegji i Ankesave e ka shqyrtuar ankesën në pajtim me nenin 61.4 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6 dhe konstaton se ankesa është e papranueshme. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave vendosi që ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Para se të trajtohet përmbajtja e ankesës, duhet të theksohet një vërejtje preliminare në lidhje me përfaqësimin e Paditësit:

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e themeluar në nëntor të vitit 2002 nga Rreg e UNMIK-ut 2002/13, e ndryshuar me Rreg e UNMIK-ut 2005/18, e pushoi operimin e saj në qershor të vitin 2008. Aktivitet e saj, përfshirë edhe përfaqësimin e ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve) pran Gjykatës Supreme, faktikisht u morrin përsipër nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Duke e marrë parasysh gjendjen faktike në teren në Kosovë me AKM-në e cila tanimë nuk po i ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e veta sipas Rreg të UNMIK-ut 2002/13, me ndryshim, dhe duke e pas parasysh se është nevojë e menjëhershme që NSH-të të përfaqësohen si duhet pran Dhomës së Posaçme, dhe duke e marrë në konsideratë se si parim themelor sistemet ligjore që e

respektojnë sundimin e ligjit nuk lejojnë vakume ligjore, përfaqësimi i NSH-ve nga AKP-ja tani për tani do të pranohet.

Prandaj, Paditësi konsiderohet si i përfaqësuar në mënyrë të duhur nga AKP-ja.

Ankesa është e pabazuar.

Neni 55.1 i UA-së të UNMIK-ut 2008/6 përcakton se me kërkesë të palës, DHPGJS-ja mund të nxjerrë një aktvendim për masë të përkohshme nëse pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për masë të përkohshme. Kërkesa për aktvendim për masë të përkohshme parashtrohet bashkë me padinë ose pas padisë së parashtruar në lidhje me atë padi. Për më tepër neni 55.2 e UA-së të UNMIK-ut 2008/6 përcakton se në rrethana të jashtëzakonshme, DHPGJS-ja mund të vendos rreth një kërkesë për ndalim të përkohshëm pa ia dorëzuar kërkesën palës tjetër.

Qëllimi i ndalimit të përkohshëm është të mbrohet paditësi nga shkaktimi i dëmit, humbjes apo dëmtimit të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nga i Padituri, veprimet e të cilit mund të konsiderohen joligjore në procedurat e mëvonshme. Për të ndërmarrë një masë të tillë, humbjet e mundshme ekonomike të të Paditurit garantohen nga Paditësi në rast se më vonë refuzohet padia e Paditësit. Nga këto arsye, parakushtet për lëshimin e ndalimit të përkohshëm, duke i pas parasysh edhe nevojën speciale të procedurës së shpejtë, nuk mund të jenë veçanërisht të rrepta.

Kërkesa e Paditësit për ndalim të përkohshëm ka të bëjë me padinë e ushtruar kundër të Paditurit të ndaloj çfarëdo lloj ndryshimi të statusit të fundit të posedimit faktik në lidhje me pronën e paluajtshme të regjistruar si ngastra kadastrave me numër 7155/1 dhe 7154/1, e cila ndodhet në "Rrugën Hekurudha" nr. 24-26 në Prishtinë. Padia u parashtrua më 7 gusht 2009 dhe e ka të njëjtën lëndë kërkesë për ndalim të përkohshëm (SCC-09-0154).

Për më tepër, Kolegji i Ankesave konsideron se rrethanat e veçanta, nën të cilat mund të lëshohet një ndalim i përkohshëm pa ia dërguar palës tjetër kërkesën, mbizotërojnë në çështjen në fjalë. Paditësi ka pohuar se puna për rrënim në

ngastrat e përmendura kanë vazhduar ende në kohën kur është ushtruar kërkesa në DHPGJS për ndalim të përkohshëm. Për të parandaluar më shumë dëmtimin, ka qenë e nevojshme të lëshohet aktvendimi në këtë çështje pa ia dërguar kërkesën të Paditurit.

I Padituri/ankuesi ka pohuar se Paditësi është ndërmarrje private, dhe së paku në ngastrën tjetër me numër 7154/1 asnjëherë nuk ka qenë pronë shoqërore. Megjithatë, i Padituri/Ankuesi deri më tani nuk e ka kontestuar posedimin e vërtetë të më hershëm të Paditësit apo të drejtën e tij për posedim të atyre ngastrave. I Padituri/Ankuesi as nuk e ka kontestuar se ka pas punë në rrënimin e atyre ngastrave, por ka shpjeguar se nuk është angazhuar në ndonjë aktivitet në pronën në fjalë.

Paditësi ia ka dorëzuar Trupit Gjykes aktvendimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë të datës 21 maj 1997. Në bazë të asaj dëshmie, NSH "██████████" është e regjistruar në regjistrin e Gjykatës së përmendur më lartë me emrin "██████████ ██████████" me lokalitet në ██████████ ██████████. Paditësi ia ka dorëzuar Trupit Gjykes edhe fotografinë e punës për rrënim.

Paditësi ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të lëshuar ndalim të përkohshëm se statusi ligjor i saj është ndërmarrje shoqërore dhe se zyrat e saj gjendeshin në ngastrat e kontestuara apo në njërën nga ato në Rrugën Hekurudha, nr. 24-26 në Prishtinë. Paditësi nuk ka ofruar dëshmi për çështjen se puna për rrënim është kryer nga i Padituri/Ankuesi. Megjithatë, kjo mungesë e dëshmisë (së plotë) nuk ka rezultuar në mohimin e ndalimit të përkohshëm. Trupi Gjykes ka pas të drejtë kur ka menduar se një dëshmi e tillë (e plotë) - në procedurat që kanë të bëjnë me ndalim të përkohshëm - nuk ka qenë e nevojshme. Në rrethanat e kësaj lënde, pretendimi bindës se puna për rrënim ishte bërë nga i Padituri/Ankuesi, në lidhje me foton e dorëzuar, ka qenë i mjaftueshëm. Nëse pretendimi i Paditësit se i Padituri ka vepruar në formën e përshkruar nuk mund të vërtetohet në procedurën e më vonshme, Paditësi është i obliguar ta kompensoj të Paditurin për dëmtimin e shkaktuar nga - atëherë pa arsyetim - lëshimi i ndalimit të përkohshëm. Kjo nuk e mbingarkon të Paditurin, të cilit me ndalim të përkohshëm vetëm i ndalohet të bëjë atë të cilën e ka pretenduar se nuk do ta bëjë apo nuk e ka bërë. Kjo është, në lidhje me dëmtimin e mundshëm

se pa ndalim të përkohshëm Paditësi mund të vuante, e cila është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit.

Kolegji i Ankesave konkludon se janë plotësuar kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 55 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6 për lëshimin e ndalimit të përkohshëm.

Trupi Gjykses do të vendos për kërkesën e të Paditurit/Ankuesit për shpenzimet gjyqësore në procedurën e ankimit kur të vendos mbi padinë e Paditësit.

Nga këto arsye vendoset si në dispozitiv.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar	
EULEX	(nënshkrimi)
Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar	
EULEX	(nënshkrimi)
Ejia-Lisa Helin, Gjyqtare	
EULEX	(nënshkrimi)
Tobias Lapke, Regjistruer	
EULEX	(nënshkrimi)